
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	
---	--	---

01-1350

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe në bazë të kërkesës 05 Nr.350/02-125932/21 dt. 01.07.2021, të pronarit Fatmir Ahmeti nga Prapashtica, me vendbanim në Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor, për ndërtimin e ndërtesës, shtëpi individuale banimore, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban - PZHU, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 19.08.2021, merr këtë:

V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore pronarit Fatmir Ahmeti nga Prapashtica, me vendbanim në Prishtinë, rr. “Nexhmi Llumnica”, sipas kërkesës 05 Nr.350/02-125932/21 dt. 01.07.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor, për ndërtimin e ndërtesës, shtëpi individuale banimore, me etazhitet P+1, në fshatin Bërnice e Epërme, e cila shtrihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban - PZHU, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 423-4, ZK Bërnice e Epërme.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban - PZHU, i miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës me 01 nr. 035-181427 dt.24.09.2013, si dhe vërtetuar në “Informim nga Plani Zhvillimor Urban – PZHU”, kjo zonë është me destinim “ndërtim individual”.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit i parcelës kadastrale, është:
 - nr. 423-4, me S=400 m², me pronar Fatmir Ahmeti, “bujqësore - arë e klasës 4”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale me nr. 423-4, nuk ka ndërtesa të ndërtuara;
- Terreni ka pjerrtësi në drejtimin veri-jug, me një rënie rreth 1.0 m’;
- Qasja ekzistuese e parcelave kadastrale është përmes parcelës - rrugës ekzistuese deri te rruga e planifikuar me Planin Zhvillimor Urban;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m’ të parcelave kadastrale, përfshihen ndërtesa banimi dhe afarsite;

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin e ndërtimit të ndërtesës, shtëpi individuale banimore, në kuadër të Planit Rregullues Urban – PZHU, Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi me qasje, pozicionimi, gabariti dhe etazhite i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesave nga kufiri i parcelës si dhe ndërtesat e tjera, rrugët e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të

- jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit – “Situacioni i ngushtë”, bashkangjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Me këto kushte ndërtimore, në kuadër të parcelës ndërtimore, planifikohet të realizohet ndërtesa, shtëpi individuale banimore, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:
 - ndërtesa, me $S=221.5 \text{ m}^2$; etazhiteti: P+1; destinimi: banim;
 - Parcela kadastrale nr. 423-4, ZK Bërnice e Epërme, ka sipërfaqe të përgjithshme $S=400.0 \text{ m}^2$, ndërsa brenda vijës rregulluese kjo sipërfaqe është $S=365.0 \text{ m}^2$, e cila do të trajtohet për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore;
 - Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, banim individual;
 - Etazhiteti i lejuar sipas Planit Zhvillimor Urban – PZHU është:
 - I-III / sipas PZHU-së;
 - P+1 / sipas projektit konceptual;
 - Indeksi i sipërfaqës së përgjithshme ndërtimore (ISPN), për parcelën ndërtimore, brenda vijës rregulluese sipas kriterëve të Planit Zhvillimor Urban - PZHU, për sipërfaqën e përgjithshme ndërtimore mbitorësore, është 0.6-0.8, dhe kjo sipërfaqe për këtë parcelë, duhet të jetë:
 - $S=365.0 \times 0.8 = 292.0 \text{ m}^2$ / e lejuar sipas PZHU-së;
 - $S=221.5 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit;
 - Koeficienti i shfrytëzimit maksimal (ISHP), të parcelës ndërtimore, brenda vijës rregulluese sipas Planit Zhvillimor Urban - PZHU, për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit në përdhese, është max. 30 %, dhe kjo sipërfaqe për këtë parcelë, duhet të jetë:
 - $S=365.0 \times 0.3 = 109.5 \text{ m}^2$ / e lejuar sipas PZHU-së;
 - $S=110.0 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit;
 - Koeficienti minimal i parcelës ndërtimore për sipërfaqe gjelbëruese (ISGJ) është minimum 40%, sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.031-185481 dt. 14.08.2015, me gjelbërim të lartë dhe të ulët, dhe kjo sipërfaqe duhet të jetë:
 - $S=365.0 \times 0.4 = 146.0 \text{ m}^2$ / sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës,
 - $S=189.0 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit;
 - Bazuar në kriteret e Planit Zhvillimor Urban – PZHU, distancat duhet të respektohen sipas të dhënave si në vijim:
 - distanca më e vogël nga kufiri i parcelës është 0.5-0.75H, ku H është lartësia e ndërtesës;
 - distanca mes ndërtesave 1-1.5H;
 - Distanca minimale e ndërtesës nga bordura e rrugës, duhet të jetë:
 - jo më pak se 5 m për rrugë me gjerësi deri në 7 m,
 - jo më pak se 7.5 m për rrugë me gjerësi deri 7-15 m,
 - Bazuar në kriteret sipërfaqja ndërtimore do të llogaritet si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** mbi tokë- suteran dhe **0%** për etazhet e nëntokës-bodrome;
 - Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe eficiencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore, ndërsa për distanca nga kufiri i parcelës dhe ISHP të ndërtesës, të llogaritet shtresa finale e fasadës së ndërtesës;
 - Qasja në ndërtesë është përmes parcelës e cila është rrugë ekzistuese, për të cilën ka pëlqim për qasje, deri te qasja në rrugë të planifikuar sipas planit;
 - Numri i vendparkingjeve sipas kriterëve të planit dhe normativës është 1 VP/për njësi banimi, ndërsa parkimi i jashtëm të planifikohet brenda vijës rregulluese;
 - Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
 - Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të eficiencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;



- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore;
- Të bëhet aplikimi i të gjitha kriterëve, normave dhe standardeve urbane, të planifikimit dhe arkitektonike të përcaktuara nga PZHU.

V. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).
- Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohitorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VI. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m, me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhese, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tredimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogaritë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme

X. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtorja e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arrijten e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarve (bashkëpronarëve të parcelave);

XI. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor - projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XII. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Aplikuesi/pronari Fatmir Ahmeti nga Prapashtica, me vendbanim në Prishtinë, rr. “Nexhmi Llumnica”, me kërkesën 05 Nr.350/02-125932/21 dt. 01.07.2021, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor, për ndërtimin e ndërtesës, shtëpi individuale banimore, me etazhitet P+1, në lokacionin e përkrahur në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë dhe gjatë fazës së shqyrtimit administrativ, aplikuesi ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- *Dëshminë mbi pronësinë, Certifikatë dhe Kopja e planit, për parcelën kadastrale nr. 423-4, ZK Bërnice e Epërme, me pronar Fatmir Ahmeti;*
- *Projektin konceptual dhe planin e situacionit të ndërtesës, të hartuar nga “SRT Worldwide” sh.p.k. me seli në Prishtinë, rr. “Fadil Hoxha”, EXDS 4, Nr.13, L. Kalabria, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811363473;*
- *Aktin noterial “Deklaratë/Pëlqim për paluajtshmëri” me LRP nr. 4419/2021, të datës 28.06.2021, të lidhur te noter Faton R. Muslija, me të cilin Shaban Rushiti, në cilësinë e pronarit të parcelës kadastrale nr. 423-5, ZK Bërnice e Epërme, i jep pëlqim për ndërtim në distancë deri 1.5 m, fqiu të tij Fatmir Ahmeti, pronar i parcelës kadastrale nr. 423-4, ZK Bërnice e Epërme;*
- *Aktin noterial “Pëlqim” me LRP. Nr. rendor: 10054/2021, të datës 03.08.2021, të lidhur te notere Sevdije S. Krasniqi, me të cilin Fehmi Kupina, në cilësinë e pronarit të parcelave kadastrale nr. 418-1 dhe 421-5, ZK Bërnice e Epërme, i jep pëlqim për shfrytëzim dhe qasje pa pengesa nëpër parcelat e tij deri në rrugë publike, Fatmir Ahmeti-t, pronar i parcelës kadastrale nr. 423-4, ZK Bërnice e Epërme;*
- *Shkresën “Informim nga Plani Zhvillimor Urban - PZHU”, me referencë: 04-350/01-94720/21 dt. 27.05.2021 të datës 02.06.2021, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm - Prishtinë;*
- *Inçizimin gjeodezik “Situacioni gjeodezik i terrenit” të parcelës kadastrale nr.423-4, ZK Bërnice e Epërme, të punuar nga gjeodeti i licencuar Milaim Dobratiqi, me licencë nr.88;*
- *Vërtetimin mbi obligimet tatimore në emër të Fatmir Ahmeti, me nr. 125835/21 (21953636) dt. 01.07.2021;*
- *Fotokopjen e dokumentit të identifikimit të pronarit;*

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, ka pranuar kërkesën 05 nr. 350/02-125932/21 dt. 01.07.2021, të pronarit Fatmir Ahmeti nga Prishtina, me anë të të cilës është kërkuar caktimi i kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor, për ndërtimin e ndërtesës, shtëpi individuale banimore, me etazhitet P+1, në fshatin Bërnice e Epërme, e cila shtrihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban – PZHU, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 423-4, ZK Bërnice e Epërme.

Pas kontrollimit të projektit konceptual nga përgjegjësi për komunikacion i kësaj drejtorie, i njëjti ka konstatuar si në vijim: *"Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Fatmir Ahmeti, në Bërnice të epërme, Prishtinë, lidhur me kërkesën e kushteve ndërtimore të lëndës 05-350/02-125932/21 dt.01.07.2021, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese me nr. te parcelës 421-5 ZK. Bernice e epërme, sipas prezantimit në situacion për ndërtesën banimore - shtëpi individuale me etazhitet P+1, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e tillë. Kyçja duhet ti përshtatet teknikisht rrugës ekzistuese dhe të aplikohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes dhe në kohën kur realizohet ajo."*

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, Rregullorës për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizik dhe juridik nr. 01 nr.110-288305 dt. 31.12.2014, rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, neni 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për ndërtim dt.31.05.2012, neni 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve, si dhe pas përfundimit të procedurës së vendosjes së njoftimit publik (28.07.2021 – 02.08.2021), meqë nuk është pranur ndonjë koment, vërejtje apo sugjerim, ka konstatuar se, kërkuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të dokumentit të planifikimit hapësinor për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Shtojcë: Plani i situacionit - Situacioni i ngushtë.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

Kjo shkresë u shtyp në 5 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit, Drejtorisë së Inspektionit, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,

05 Nr. 350/02-125932/21 DT. 19.08.2021

Zyrtar:

Liridon Gashi



U.D. Udhëheqëse e Sektorit:

Mimoza Berisha Prestreshi



Drejtor:

Ardian Ollari



Parcela kadastrale - 423-4

Zona kadastrale - Prishtine Certifikata e nj.kadastrale - P-71914013-00423-4

Plani Rregullues PZHU , Vendimi i Planit - Plani Zhvillimore Urban - 01 nr. 035-181427
dt.24.09.2013


Destinimi - Ndertim individual

Struktura urbane , parametrat e ndertimit - D1 / min 100 - max 150 ban/ha

ISHP - 0.2 - 0.3


Etazhiteti I - III

Vija ndertimore - Vija rregulluese - jo me pak se 5 m per rruge me gjerese deri ne 7 m



Legjenda :

Projektim dhe Ndërtim



SRT WORLDWIDE

Rruga : Fadil Hoxha / Exdc 4 / Hyrja 1 / Nr.13

Qyteti : Prishtinë

Shieli : Kosovë

Kodi postal : 10000

Titulli i Punës :

Projekti Ideor

Faza e Projektit :

Arkitekturë

Vizatimi :

Plani i situacionit te ngushtë

V.V :



Nenshkrimi :

Statusi i Projektit :

Vizatuar nga : **Salih Hamzaj , Bsc** Data : Qeshore 2021

Kontrolluar nga : Data :

Perpjese e Vizalimit :

P/1:200 A3

Numri i Fletës :

F2